

Партнерство за
Отворена
Власт на
**Северна
Македонија**



RAPORTIM I PAVARUR:

Republika e Maqedonisë së Veriut

FUSHA PRIORITARE:

Përparimi i dhënies së shërbimeve publike

RAPORT PËR IMPLEMENTIMIN:

tetor 2021 – tetor 2022

Vlatko Dekov, HOPS - Opsione për jetë të shëndetshme Shkup





Во пресрет на подготовката на петтиот Национален акциски план за Партнерство за отворена власт 2021-2023 година (НАП за ПОВ 2021-2023), се формираше Мрежа на граѓански организации за ПОВ со цел поорганизирано делување и влијание на граѓанските организации на неговото креирање, како и поттикнување и мониторинг на имплементацијата на постојниот и идните акциски планови.

Со цел обезбедена вклученост на граѓанските организации во поддршка и следење на имплементацијата на НАП за ПОВ 2021-2023, Мрежата за ПОВ учествува и придонесува за воспоставување структура за координација и мониторинг на развојот и спроведувањето на НАП за ПОВ 2021-2023 обезбедувајќи независен мониторинг на имплементацијата.

PËRMBAJTJA



Rezymeja përmbledhëse:

Republika e Maqedonisë së Veriut -

Përparimi i dhënies së shërbimeve publike 5

I. Hyrja 9

II. Implementimi i planit aksional -

Përparimi i dhënies së shërbimeve publike 10

III. Metodologjia dhe burimet 20

Aneksi I. 21

Pasqyra e implementimit të fushës prioritare -

Përparimi i dhënies së shërbimeve publike 21

Ekzemplarin e këtij raporti e përpiloi Darko Antiq nga Shoqëria ESE në bazë të ekzemplarëve të raportit të MRP-së (mekanizmi për raportim të pavarur). Ekzemplari është përpiluar për përgatitje të raporteve, të cilat janë pjesë e procesit për vlerësim dhe monitorim të pavarur të Planit Aksional për PQH të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga përfaqësuesit e organizatave qytetare të cilat janë anëtare të Rrjetit Nacional të OQ-ve për PQH.



Association for emancipation,
Solidarity and equality
of women - ESE

REZYMEJA PËRMBLEDHËSE:

Republika e Maqedonisë së Veriut -
Përparimi i dhënies së shërbimeve



Në përgatitjen e fushës prioritare “Përparimi i dhënies së shërbimeve publike” kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve relevante dhe përfaqësues të organizatave qytetare. Procesi ka qenë i hapur për të gjithë dhe anëtarët e grupeve të punës kishin mundësi të japin kontributin e vet në përcaktimin e angazhimeve dhe propozimin e aktiviteteve përkatëse për realizimin e tyre. Nuk ekziston angazhim i cili nuk është pranuar. Puna është zhvilluar në atmosferë demokratike, komunikimi ka qenë në nivelin përkatës dhe bashkëpunimi midis organizatave qytetare dhe institucioneve publike ka qenë i mirë dhe partner. Nuk janë detektuar probleme në nivel të komunikimit midis organizatave qytetare dhe institucioneve publike.

Monitorimi dëshmoi se asnjë nga tetë angazhimet e planifikuara nuk ka zbatim të theksueshëm apo të tërësishëm. Në disa angazhime, si për shembull, angazhimi “Zmadhimi i qasjes të format e garantuara të mbrojtjes së viktimave të tregtisë me njerëz”, ekzistojnë më shumë arritje të cilat po realizohen, kurse në angazhime të tjera, si për shembull, angazhimi “Shërbimet publike dhe politikat e bazuara në prioritetet qytetare nga fusha e arsimit”, Ministria e Arsimit si institucion koordinator informon se nuk ka të dhëna për fillimin e ndonjë prej aktiviteteve të parapara. Pjesa më e madhe e angazhimeve nuk kanë filluar me realizimin ose në vijim është vetëm një aktivitet, përkatësisht arritje e paraparë.

Ekzistojnë disa arsye që kanë çuar në mospërbushjen e angazhimeve, por i përmenduri më shpesh nga anëtarët e grupeve të punës është ndërrimi i shpeshtë i koordinatorëve të grupeve të punës dhe mosmbajtja e mbledhjeve.

Në atë kontekst, është e nevojshme që institucionet të përmbahen nga ndryshimi i shpeshtë i koordinatorëve, ndërsa vetë koordinatorët e grupeve të punës duhet të informojnë institucionet e tyre për procesin e PQV-së dhe për rëndësinë dhe nevojën e përmbushjes së planit nacional aksional. Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA), si koordinatorë nacionale e të gjithë procesit, duhet ta përforcojë komunikimin e ndërsjellë me koordinatorët e grupeve të punës dhe të tregojë proaktivitet më të madh në monitorimin e përmbushjes së të gjitha prioriteteve.

PASQYRË E PËRGJITHSHME E FUSHËS PRIORITARE

Fusha prioritare “Përparimi i dhënies së shërbimeve publike” ka planifikuar tetë angazhime dhe aktivitete përkatëse për realizimin e tyre për periudhën tetor 2021 deri në qershor 2023. Këto janë tetë angazhimet e përcaktuara:

- 1. Shërbimet publike dhe të politikat e bazuar në prioritetet qytetare nga fusha e punësimit.
- 2. Shërbimet publike dhe të politikat e bazuar në prioritetet qytetare nga fusha e mbrojtës shëndetësore parandaluese.
- 3. Shërbimet publike dhe të politikat e bazuar në prioritetet qytetare nga fusha e arsimit.
- 4. Shërbimet publike dhe të politikat e bazuar në prioritetet qytetare nga fusha e sigurimit të shërbimeve lokale publike.
- 5. E-shërbime të qasshme në mjediset rurale.
- 6. Zmadhimi i qasjes të format e garantuara të mbrojtjes së viktimave të tregtisë me njerëz.
- 7. Përparimi i mekanizmave për mbrojtjen e viktimave nga shqetësimi në vendin e punës.
- 8. Mundësimi i qasjes të terapia dhe shërbimet shëndetësore për personat që përdorin drogë për vuajtjes së dënimit me burg.

Ky raport e analizon periudhën e zbatimit nga tetori 2021 deri në tetor 2022.

Në përputhje me raportin e INM-së për Maqedoninë e Veriut 2022, dy angazhimet e para (Punësimi dhe Mbrojtja shëndetësore parandaluese) janë vlerësuar si angazhime që mund të çojnë drejt transformimit fundamental të shërbimeve sipas nevojave të vërteta të qytetarëve¹. Megjithatë, në praktikë situata nuk është kaq premtuese. Domethënë, kjo analizë dëshmoi se asnjë nga tetë angazhimet e planifikuara nuk është realizuar tërësisht. Në disa prej angazhimeve, si për shembull, “Zmadhimi i qasjes të format e mbrojtjes së viktimave të tregtisë me njerëz” ekzistojnë shumë arritje që janë në realizim, kurse në angazhime të tjera, si për shembull, angazhimin “Shërbime publike dhe politika të bazuara në prioritetet qytetare nga fusha e arsimit”, Ministria e Arsimit si institucion koordinator informon se nuk ka të dhëna për fillimin e ndonjë prej aktiviteteve të parapara. Pjesa më e madhe e angazhimeve nuk kanë filluar me realizimin ose në vijim është vetëm një aktivitet, përkatësisht arritje e paraparë. Shkaqet më të shpeshta për mosrealizimin e aktiviteteve janë si vijon:

- Mungesa e monitorimit, por dhe dëshira për zbatim të obligimeve nga institucionet.
- Shumica e institucioneve nuk janë njohur sa duhet me procesin e PQH dhe nuk dinë se përse kanë marrë obligim.

¹ <https://www.opengovpartnership.org/documents/north-macedonia-action-plan-review-2021-2023/>

→ MSHIA-ja, si koordinatorë nacionale e të gjithë procesit nuk është angazhuar sa duhet që ta përmirësojë plotësimin e angazhimeve. Ministria nuk ka kontroll në lidhje me faktin se a i kanë ndryshuar institucionet koordinatorët dhe se a i zbatojnë ato obligimet e vete.

→ Ndryshimi i shpeshtë i koordinatorëve të grupeve të punës.

→ Ndryshimi i shpeshtë i anëtarëve të grupeve të punës.

→ Disa anëtarë këtë e kuptojnë si obligim shtesë dhe u përgjigjen me vështirësi detyrave.

→ Mosmbajta e mbledhjeve të grupeve të punës.

TABELA 1.

PASQYRË E SHPEJTË

Ky prioritet ekziston nga: tetori i vitit 2021.

Periudha e implementimit, që është lëndë e raportimit: tetor 2021 - tetor 2022.

Numri i angazhimeve në suazat e prioritetit: 8

ZHVILLIMI I PRIORITETIT

Ниво на отвореност и учество: отворен

Гласот на ГО: помеѓу умерено влијание и големо влијание

Вклученост на јавните институции: помеѓу ограничена и голема

IMPLEMENTIMI

Angazhime të miratuara: 8

Angazhime të realizuara tërësisht: 0

Niveli i bashkëpunimit me OQ-të dhe institucionet publike: i lartë.

PESË REKOMANDIME KRYESORE

Ato kanë për qëllim të informojnë zhvillimin e angazhimeve, të cilat janë pjesë e prioritetit që vlerësohet në planin e ardhshëm aksional dhe ta drejtojnë zbatimin e planit aktual aksional. Monitorimi rekomandon si më poshtë:

Një nga problemet kryesore për mosplotësimin e arritjeve të parapara është ndryshimi i koordinatorëve të grupeve të punës dhe i anëtarëve të grupeve të punës. Kjo ndikon mbi vazhdimësinë e punës së grupeve të punës. Është e dëshirueshme që institucionet që janë koordinatorë të grupeve të punës të mos kryejnë ndryshim të shpeshtë të koordinatorëve dhe anëtarëve.

Koordinatorët e grupeve të punës t'i informojnë institucionet personale mbi vetë procesin e PQH-së dhe mbi rëndësinë dhe nevojën e përmbushjes së planit nacional aksional.

Për të nxitur plotësimin e këtij prioriteti, nevojitet koordinatorët e çdo grupi pune të caktojnë takime në bazë të rregullt. Në këto takime të diskutohet për plotësimin e çdo aktiviteti të paraparë, kurse pas përfundimit të takimit të përpilohet procesverbal me përfundime dhe ai t'u dorëzohet të gjithë anëtarëve të grupit të punës.

MSHIA-ja si koordinatorë nacionale e të gjithë procesit duhet ta përforcojë komunikimin e ndërsjellë me koordinatorët e grupeve të punës dhe të tregojë proaktivitet më të madh në monitorimin e përmbushjes së të gjitha prioritetëve.

PËR AUTORIN

Vlatko Dekov është menaxher për përfaqësim të shoqatës HOPS - Opsione për jetë të shëndetshme - Shkup. Ka marrë pjesë në përgatitjen e shumë strategjive nacionale dhe dokumenteve për politikën publike. Ka zbatuar mbi 20 hulumtime dhe analiza në nivel nacional dhe ndërkombëtar.





I. HYRJA



Partneriteti për qeverisje të hapur është iniciativë globale e cila bashkon reformatorët e pushtetit dhe liderët e shoqërisë qytetare në krijimin e planeve aksionale që pushteti të jetë më inkluziv, më i përgjegjshëm dhe më llogaridhënës. Angazhimet e planit aksional në fushën prioritare Përparimi i dhënies së shërbimeve publike mund të mbindërtohen mbi angazhimet ekzistuese, të identifikojnë hapa të rinj për realizimin e reformave aktuale ose të iniciojnë aksion në një fushë krejtësisht të re. Monitorimi i pavarur i angazhuar për përpilimin e këtij raporti zbatoi një sërë aktivitete për vlerësimin e implementimit të angazhimeve që të sigurohet se pushteti do të mbetet i përkushtuar në zbatimin e tyre. Liderët e shoqërisë qytetare dhe të pushtetit i përdorin këto evalvime që të reflektojnë mbi përpilimin personal dhe të përcaktojnë se a ndikojnë aksionet e ndërmarra mbi jetën e njerëzve.

Republika e Maqedonisë së Veriut merr pjesë në PQH nga viti 2011 dhe deri më tani ka miratuar pesë plane aksionale. Plani i pestë aksional (2021 - 2023) e tejkalon ambicien e planeve të mëparshme, sidomos në lidhje me transparencën e prokurimeve publike, dërgimin e shërbimeve publike dhe qasjen te drejtësia për grupet vulnerabile. Zbatimi i tërësishëm i planit mund ta bëjë Republikën e Maqedonisë së Veriut lidere rajonale në Ballkanin Perëndimor në fushat kryesore të qeverisjes së hapur dhe t'i adresojë prioritetet e procesit të aderimit në BE.



Duke pasur parasysh spektrin dhe vëllimin e planit aksional, nevojitet bashkëpunim i ngushtë midis institucioneve publike dhe shoqërisë qytetare në arritjen e rezultateve të rëndësishme. Angazhimet e Planit të pestë aksional të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë organizuar në pesë fusha tematike: transparenca, antikorrupsioni, dërgimi i shërbimeve publike, qasja te drejtësia dhe mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike. Angazhimet mbulojnë një numër të madh temash duke përfshirë edhe prokurimet publike, ndjekjen e paraqitjeve të gjendjes pronësore të funksionarëve publikë, integrimin e prioriteteve qytetare në dërgimin e shërbimeve publike dhe përforcimin e qasjes te ndihma juridike pa pagesë. Republika e Maqedonisë së Veriut po e zbaton edhe planin e saj të dytë për parlament të hapur dhe planin e parë aksional për gjyqësor të hapur për përforcim të transparencës së pushtetit gjyqësor.

Vlerësimin e bëri monitoruesi i pavarur Vlatko Dekov nga shoqata HOPS - Opsione për jetë të shëndetshme - Shkup, i cili e ka bërë këtë evalvim. Raporti ka për qëllim ta informojë dialogun aktual për zhvillim dhe zbatim të angazhimeve të ardhshme.

Ky raport e përfshin implementimin e angazhimeve në suazat e fushës Përparimi i dhënies së shërbimeve publike nga plani i pestë aksional i Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2021 - 2023.



II. ZBATIMI I PLANIT AKSIONAL - PËRPARIMI I DHËNIES SË SHËRBIMEVE PUBLIK



2.1. PASQYRË E PLANIT AKSIONAL - PËRPARIMI I DHËNIES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në përgatitjen e kësaj fushe me prioritet kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve relevante dhe përfaqësues të organizatave qytetare. Procesi ka qenë i hapur dhe të gjithë anëtarët e grupeve të punës kanë pasur mundësi të japin kontributin e vet në përcaktimin e angazhimeve dhe propozimin e aktiviteteve përkatëse për realizimin e tyre. Nuk ekziston angazhim i cili nuk është pranuar. Puna është zhvilluar në atmosferë demokratike, komunikimi ka qenë në nivelin përkatës dhe bashkëpunimi midis organizatave qytetare dhe institucioneve publike ka qenë i mirë dhe partner. Nuk janë detektuar probleme në nivel të komunikimit midis organizatave qytetare dhe institucioneve publike.

Asnjë nga tetë angazhimet e planifikuara nuk ka zbatim të theksuar apo të tërësishëm. Në disa angazhime, si për shembull, angazhimi “Zmadhimi i qasjes të format e garantuara të mbrojtjes së viktimave të tregtisë me njerëz”, ekzistojnë më shumë arritje të cilat po realizohen, kurse në angazhime të tjera, si për shembull, angazhimi “Shërbimet publike dhe politikat e bazuara në prioritetet qytetare nga fusha e arsimit”, Ministria e Arsimit si institucion koordinator informon se nuk ka të dhëna për fillimin e ndonjë prej aktiviteteve të parapara. Pjesa më e madhe e angazhimeve nuk kanë filluar me realizimin ose në vijim është vetëm një aktivitet, përkatësisht arritje e paraparë. Shkaqet më të shpeshta për mosrealizimin e aktiviteteve janë:

- Mungesa e monitorimit, por dhe dëshirës për përfundim të obligimeve nga institucionet.
- Shumica e institucioneve nuk janë njohur sa duhet me procesin e PQH dhe nuk dinë se përse kanë marrë obligim.
- MSHIA-ja, si koordinatorë nacionale e të gjithë procesit nuk është angazhuar sa duhet që ta përmirësojë plotësimin e angazhimeve. Ministria nuk ka kontroll në lidhje me faktin se a i kanë ndryshuar institucionet koordinatorët dhe se a i zbatojnë ato obligimet e vete.
- Ndryshimi i shpeshtë i koordinatorëve të grupeve të punës.
- Ndryshimi i shpeshtë i anëtarëve të grupeve të punës.

→ Disa anëtarë këtë e kuptojnë si obligim shtesë dhe u përgjigjen me vështirësi detyrave.

→ Mosmbajta e mbledhjeve të grupeve të punës.

Në këtë periudhë të zbatimit nuk mund të konstatojmë se ndonjë nga përpjekjet ka arritur ndryshime të mëdha apo të jashtëzakonshme për qeverisjen e hapur.

2.2. ANGAZHIME

I. Shërbime publike dhe politika të bazuara në prioritetet qytetare nga fusha e punësimit

RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO	1. Statusi i implementimit: i kufizuar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO , qasje tek informacionet, pjesëmarrje qytetare, llogaridhënie publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: JO

Qëllimi kryesor dhe afatgjatë i angazhimit është vendosja e sistemit të organizuar dhe praktikës për komunikim të dyanshëm midis qytetarëve dhe dhënësve të shërbimeve gjatë planifikimit, zbatimit dhe evaluimit të politikave të punësimit. **ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN dhe mundëson qasje tek më shumë informacione të reja**, e përmirëson cilësinë e informacioneve dhe qasjes tek informacionet nga opinioni ose mundëson të drejtë të informacioneve. **ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN QYTETARE** dhe krijon ose i përmirëson mundësitë dhe shërbimet për pjesëmarrjen publike dhe ndikim në vendime, krijon ose e përmirëson mjedisin mundësues për shoqëri qytetare.

ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE dhe krijon ose i përmirëson rregullat, dispozitat dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionarëve.

Ky angazhim nuk është realizuar. Është përmbushur vetëm një aktivitet nga plani aksional. Është formuar trup koordinues, i përbërë nga shtatë anëtarë, të cilët do të punojnë në koordinimin e aktiviteteve: nga një përfaqësues nga çdo organizatë qytetare e përfshirë në këtë aktivitet (5 përfaqësues të organizatave qytetare, prej të cilave një nga niveli kombëtar dhe katër nga niveli lokal), një përfaqësues nga sektori i punës në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe një përfaqësues i Agjencisë së Punësimit. Të gjitha aktivitetet e tjera të parashikuara në planin nacional aksional nuk janë zbatuar, kurse disa nuk kanë filluar as të zbatohen. Nevojitet të theksohet se kur një aktivitet i ka të gjitha kushtet për

t'u plotësuar, kjo nuk ndodh për arsye të paqarta. Domethënë, në kuadër të aktivitetit – Platformë elektronike e zhvilluar për informim, monitorim dhe përfshirje të qytetarëve në politikat dhe shërbimet aktive të punësimit, është krijuar platforma elektronike e paraparë, por ajo nuk është vendosur në ueb-faqen e Agjencisë për Punësim në RMV.

Sipas informacioneve të marra, faktori kryesor i mospërbushjes së këtij angazhimi është mungesa e monitorimit, por edhe dëshira për zbatimin e detyrimeve nga institucionet. Vetë institucionet nuk e njohin sa duhet procesin e PQH-së dhe nuk e dinë se për çfarë kanë marrë obligim. Gjithashtu, nuk ka takime të rregullta të grupit punues për këtë angazhim, kurse takimi i fundit është mbajtur në muajin shkurt. MSHIA, si koordinatore nacionale e të gjithë procesit, duhet të tregojë një proaktivitet më të madh në drejtim të përmirësimit të përmbushjes së angazhimeve.

II. Shërbime publike dhe politike të bazuara në prioritetet qytetare në fushën e mbrojtjes shëndetësore parandaluese



RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO	1. Statusi i implementimit: i kufizuar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO , qasje tek informacionet, pjesëmarrje qytetare, llogaridhënie publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: JO

Qëllimi kryesor dhe afatgjatë i angazhimit është vendosja e sistemit të organizuar dhe praktikës për komunikim të dyanshëm midis qytetarëve dhe dhënësve të shërbimeve gjatë planifikimit, zbatimit dhe evaluimit të politikave shëndetësore, politikave të punësimit, politikave të arsimit dhe shërbimeve publike lokale. **ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN** dhe mundëson qasje tek më shumë informacione të reja, e përmirëson cilësinë e informacioneve dhe qasjes tek informacionet nga opinioni ose mundëson të drejtë të informacioneve. **ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN QYTETARE** dhe krijon ose i përmirëson mundësitë dhe shërbimet për pjesëmarrjen publike dhe ndikim në vendime, krijon ose e përmirëson mjedisin mundësues për shoqëri qytetare.

ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE dhe krijon ose i përmirëson rregullat, dispozitat dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionarëve.

Për këtë angazhim nuk kemi marrë përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë, e cila është koordinatore e angazhimit për faktin se cilat aktivitete janë realizuar. Në përputhje me informacionet e marra nga anëtarët e tjerë të grupit të punës, **ky angazhim nuk është realizuar**. Është përmbushur vetëm një aktivitetet të planit aksional. Është formuar trup koordinativ i përbërë nga shtatë anëtarë të cilët do të punojnë në koordinimin e aktivitetit. Të gjitha aktivitetet e tjera janë paraparë në planin aksional nacional nuk janë realizuar.

III. Shërbime publike dhe politike të bazuara në prioritetet qytetare në fushën e arsimit

RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO	1. Statusi i implementimit: i kufizuar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO , qasje tek informacionet, pjesëmarrje qytetare, llogaridhënie publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: JO

Qëllimi kryesor dhe afatgjatë i angazhimit është vendosja e sistemit të organizuar dhe praktikës për komunikim të dyanshëm midis qytetarëve dhe dhënësve të shërbimeve gjatë planifikimit, zbatimit dhe evalvimit të politikave shëndetësore, politikave të punësimit, politikave të arsimit dhe shërbimeve publike lokale. **ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN** dhe mundëson qasje tek më shumë informacione të reja, e përmirëson cilësinë e informacioneve dhe qasjes tek informacionet nga opinioni ose mundëson të drejtë të informacioneve. **ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN QYTETARE** dhe krijon ose i përmirëson mundësitë dhe shërbimet për pjesëmarrjen publike dhe ndikim në vendime, krijon ose e përmirëson mjedisin mundësues për shoqëri qytetare.

ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE dhe krijon ose i përmirëson rregullat, dispozitat dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionarëve.

Ky angazhim nuk është realizuar. Në përputhje me përgjigjet e dorëzuara nga Ministria e Arsimit deri në tetor 2022, Ministria ka informacione për zbatimin vetëm të një aktiviteti nga PNA-ja në fushën e arsimit. Për të gjitha angazhimet e tjera kjo Ministri informoi se nuk ka informacione. Sipas anëtarëve të grupit të punës, një nga faktorët kryesorë për mosplotësimin e këtij angazhimi është ndryshimi i shpeshtë i anëtarëve të grupit të punës, duke përfshirë edhe ndryshimin e koordinatorit të grupit.

IV. JShërbime publike dhe politike të bazuara në prioritetet qytetare në fushën e sigurimit të shërbimeve publike lokale

RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO	1. Statusi i implementimit: i kufizuar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO , qasje tek informacionet, pjesëmarrje qytetare, llogaridhënie publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: JO

Qëllimi kryesor dhe afatgjatë i angazhimit është vendosja e sistemit të organizuar dhe praktikës për komunikim të dyanshëm midis qytetarëve dhe dhënësve të shërbimeve gjatë planifikimit, zbatimit dhe evalvimit të politikave shëndetësore, politikave të punësimit, politikave të arsimit dhe shërbimeve publike lokale. **ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN** dhe mundëson qasje tek më shumë informacione të reja, e përmirëson cilësinë e informacioneve dhe qasjes tek informacionet nga opinioni ose mundëson të drejtë të informacioneve. **ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN QYTETARE** dhe krijon ose i përmirëson mundësitë dhe shërbimet për pjesëmarrjen publike dhe ndikim në vendime, krijon ose e përmirëson mjedisin mundësues për shoqëri qytetare.

ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE dhe krijon ose i përmirëson rregullat, dispozitat dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionarëve.

Ky angazhim nuk është realizuar. Në përputhje me përgjigjet e dorëzuara nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, aktivitetet e parapara janë në fazën e përgatitjes për përmbushje finale të tyre dhe ato do të realizohen deri në fund të vitit. Sipas anëtarëve të këtij grupi pune, ka pasur një numër të madh takimesh për përpilim të PNA-së dhe përcaktimin e prioritetëve, por pas miratimit të tij nuk është mbajtur asnjë takim.



V. E-shërbime të qasshme në mjediset rurale

RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO	1. Statusi i implementimit: Për këtë angazhim nuk janë marrë informacione relevante që të vlerësohet a nuk ka filluar zbatimi apo është i kufizuar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO , qasje tek informacionet, pjesëmarrje qytetare, llogaridhënie publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: JO

Qëllimi kryesor i angazhimit është afrimi i Portalit nacional për e-shërbime të qytetarët nga mjediset rurale dhe zmadhimi i besimit dhe sigurisë në komunikimin elektronik me institucionet.

ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN dhe mundëson qasje tek më shumë informacione të reja, e përmirëson cilësinë e informacioneve dhe qasjes tek informacionet nga opinioni ose mundëson të drejtë të informacioneve. **ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN QYTETARE** dhe krijon ose i përmirëson mundësitë dhe shërbimet për pjesëmarrjen publike dhe ndikim në vendime, krijon ose e përmirëson mjedisin mundësues për shoqëri qytetare.

ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE dhe krijon ose i përmirëson rregullat, dispozitat dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionarëve.

Për këtë angazhim nuk morëm përgjigje kthyesë nga Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë, e cila është koordinatore e angazhimit mbi faktin cilat aktivitete janë realizuar. Gjithashtu në ueb-faqen e Partneritetit për Qeverisje të Hapur, e cila është në suazat e Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë, për këtë angazhim nuk janë vendosur informacione të reja mbi statusin e zbatimit të angazhimit. Informacionet e fundit janë nga nëntori i vitit 2021 dhe sipas tyre nuk është realizuar asnjë nga 4 arritjet e parapara. Në përputhje me informacionet e marra nga anëtarët e tjerë të grupit të punës, pas miratimit të planit aksional nuk është mbajtur asnjë takim i këtij grupi pune dhe sipas tyre **ky angazhim nuk është realizuar.**

VI. Zmadhimi i qasjes te format e garantuara të mbrojtjes së viktimave të tregtisë me njerëz



RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO	1. Statusi i implementimit: i kufizuar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO , qasje tek informacionet, pjesëmarrje qytetare, llogaridhënie publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: JO

Qëllimi kryesor i këtij angazhimi është përforcimi i luftës kundër tregtisë me njerëz në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe sigurimi i mbrojtjes efikase të viktimave. Si rezultate specifike që priten nga ky angazhim janë:

- Zmadhim i numrit të viktimave të identifikuara të tregtisë me njerëz dhe shërbime të siguruara.
- Zmadhim i transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve të cilat punojnë mbi çështjen e tregtisë me njerëz.
- Zmadhim i informimit dhe qasjes për viktimat e tregtisë me njerëz te shërbimet shëndetësore, punësimi dhe drejtësia.

ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN dhe mundëson qasje tek më shumë informacione të reja, e përmirëson cilësinë e informacioneve dhe qasjes tek informacionet nga opiniononi ose mundëson të drejtë të informacioneve. **ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN QYTETARE** dhe krijon ose i përmirëson mundësitë dhe shërbimet për pjesëmarrjen publike dhe ndikim në vendime, krijon ose e përmirëson mjedisin mundësues për shoqëri qytetare.

ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE dhe krijon ose i përmirëson rregullat, dispozitat dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionarëve.

Ky angazhim është realizuar pjesërisht. Sipas koordinatores së grupit të punës dhe raportit të shpallur në ueb-faqen e Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë, deri më tani nga 8 arritjet e parapara në suazat e këtij angazhimi, një arritje është me progres të theksuar, kurse 3 të tjerat kanë një progres të caktuar të kufizuar. Katër arritje nuk kanë asnjë lloj progresi. Si problem theksohet fakti se nuk dorëzojnë informacione të gjithë anëtarët. Disa anëtarë këtë e kuptojnë si obligim shtesë dhe e kanë të vështirë t'u përgjigjen obligimeve. Edhe në këtë grup ka ndryshim të bashkëkoordinimit. Së pari koordinatore ishte Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, kurse momentalisht është Ministria e Punëve të Brendshme.

VII. Përparimi i mekanizmave për mbrojtjen e viktimave nga shqetësimi në vendin e punës

RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO	1. Statusi i implementimit: i kufizuar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO , qasje tek informacionet, pjesëmarrje qytetare, llogaridhënie publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: JO

Qëllimi kryesor i angazhimit është të përparohet mekanizmi i vendosur për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës. **ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN dhe mundëson qasje tek më shumë informacione të reja, e përmirëson cilësinë e informacioneve dhe qasjes tek informacionet nga opinioni ose mundëson të drejtë të informacioneve. ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN QYTETARE** dhe krijon ose i përmirëson mundësitë dhe shërbimet për pjesëmarrjen publike dhe ndikim në vendime, krijon ose e përmirëson mjedisin mundësues për shoqëri qytetare.

ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE dhe krijon ose i përmirëson rregullat, dispozitat dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionarëve.

Ky angazhim nuk është realizuar. Sipas koordinatorës të grupit të punës, deri më tani nga tri arritjet e parapara në suazat e këtij angazhimi, një ka progres të theksueshëm, një ka nisur dhe një arritje nuk ka asnjë lloj progresi. Edhe në këtë grup është bërë ndryshim i koordinatorit në prill të vitit 2022.



VIII. Mundësimi i qasjes te terapia dhe shërbimet shëndetësore për personat që përdorin drogë pas vuajtjes së dënimit me burg

RAPORTI PËR DIZAJNIN	RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN
1. Angazhimi është zhvilluar nëpërmjet procesit të hapur dhe konsultues me pjesëmarrje të palëve të prekura relevante: PO	1. Statusi i implementimit: i kufizuar
2. Angazhimi është relevant për PQH-në: PO , qasje tek informacionet, pjesëmarrje qytetare, llogaridhënie publike	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: JO

Qëllimi kryesor i këtij angazhimi është trajtimi i barabartë dhe qasja e lehtësuar te të drejtat për mbrojtje shëndetësore për personat që përdorin drogë, nëpërmjet përfshirjes së personave të pa siguruar që përdorin drogë në Programin për sigurimin e personave të pasiguruar, bashkëpunimit të zmadhuar ndërsektorial midis qendrave ditore të parandalimit dhe trajtimit të keqpërdorimit dhe varësisë nga droga, Drejtorisë së Zbatimit të Sanksioneve, Fondit të Sigurimit Shëndetësor dhe Ministrisë së Punëve të brendshme, sensibilizimit të kuadrit mjekësor për veprim me persona që përdorin drogë nëpërmjet trajnimeve, dallimit të organizatave joqeveritare si dhënës të shërbimeve me Ligjin për mbrojtjen shëndetësore, dhënien në kohë dhe azhurnimin e dokumenteve për identifikim personal dhe miratimin e aktit për procedurë të lehtësuar për nxjerrjen e letërnjoftimit për personat që nuk e kanë nxjerrë letërnjoftimin.

REZULTATET E PRITURA:

- Sigurim dhe azhurnim në kohë i letërnjoftimeve për personat që përdorin drogë gjatë vuajtjes së dënimit me burg, si dhe pas daljes nga institucioni.
- Trajtim i barabartë mosdiskriminim i personave që përdorin drogë nga personeli mjekësor.
- Qasje e lehtësuar të të drejtat e mbrojtjes shëndetësore për personat që përdorin drogë.
- Bashkëpunim i vendosur ndërsektorial midis qendrave ditore për parandalim dhe trajtim të keqpërdorimit dhe varësisë nga drogat, Drejtorisë së Zbatimit të Sanksioneve, Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë së Punëve të brendshme.


ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN dhe mundëson qasje tek më shumë informacione të reja, e përmirëson cilësinë e informacioneve dhe qasjes tek informacionet nga opinioni ose mundëson të drejtë të informacioneve. ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN QYTETARE dhe krijon ose i përmirëson mundësitë dhe shërbimet për pjesëmarrjen publike dhe ndikim në vendime, krijon ose e përmirëson mjedisin mundësues për shoqëri qytetare.

ANGAZHIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE dhe krijon ose i përmirëson rregullat, dispozitat dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionarëve.

Edhe përkrah komunikimit dhe kërkesave të dorëzuara për informacione me karakter publik në Ministrinë e Shëndetësisë, e cila është koordinatore e këtij angazhimi, nuk morëm përgjigje se cilat aktivitete janë realizuar. Në përputhje me informacionet e marra nga anëtarët e tjerë të këtij grupi, **ky angazhim nuk është realizuar**. Gjithashtu në ueb-faqen e Partneritetet për Qeverisja të Hapur, sipas informacioneve të fundit nga tetori i vitit 2022, thuhet se nuk është realizuar asnjë nga 3 arritjet e parapara.



III. METODOLOGJIA DHE BURIMET



Në këtë raport janë përdorur të dhëna të marra nëpërmjet intervistave me anëtarët e grupeve të punës për çdo angazhim më vete, nëpërmjet kërkesave për informacione me karakter publik dërguar institucioneve kompetente dhe nëpërmjet analizës desktop të informacioneve dhe raporteve që janë në dispozicion. Nevojitet të theksohet se dy ministri (Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë) prej të cilave janë dorëzuar kërkesa për informacione me karakter publik nuk iu përgjigjën kërkesave.

Raporti i IRM për Republikën e Maqedonisë së Veriut

<https://www.opengovpartnership.org/documents/north-macedonia-action-plan-review-2021-2023/>

Ueb-portali për ndjekjen e PNA-së

<https://ovp.gov.mk/%d1%81%d0%bb%d0%b5%d0%b4%d0%b5%d1%9a%d0%b5-%d0%bd%d0%b0-%d0%bd%d0%b0%d0%bf/>

ANEKSI I.

PASQYRA E IMPLEMENTIMIT TË PËRPARIMIT TË DHËNIES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

Legjenda



E GJELBËR = i realizuar (i përfunduar)







E VERDHË = në vijim (vetëm nëse ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm dhe angazhimi do të realizohet)





E KUQE = angazhim i pafilluar ose i filluar, por nuk ka përparim në implementim





Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
3.1.	Shërbime publike dhe politika të bazuara në prioritetet qytetare nga fusha e punësimit	Është formuar trup koordinues, i përbërë nga shtatë anëtarë, të cilët do të punojnë në koordinimin e aktiviteteve, përkatësisht: një përfaqësues nga çdo organizatë qytetare e përfshirë në këtë aktivitet (5 përfaqësues të organizatave qytetare, nga të cilët një nga niveli kombëtar dhe katër nga niveli lokal), një përfaqësues nga sektori i punës në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe një përfaqësues i Agjencisë së Punësimit.	
		Është krijuar platformë elektronike për informimin, monitorimin dhe përfshirjen e qytetarëve në politikat dhe shërbimet aktive të punësimit.	
		Është zbatuar fushatë për informim të publikut mbi mundësitë që i ofron platforma, nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të një strategjie komunikimi	


Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
		<p>Është vendosur bashkëpunim pilot me OQ-të nga Tetova, Kumanova, Shuto Orizari dhe Prilepi për identifikimin e qytetarëve të papunë të peregjistruar dhe qytetarëve nga kategoritë vulnerable me qëllim të zbatimit të aktiviteteve për njohjen e qytetarëve me të drejtat e tyre që rrjedhin nga politikat dhe shërbimet aktive të punësimit nëpërmjet përdorimit të një qasjeje shumëdisiplinore, si dhe lehtësimin e procesit të shprehjes së mendimeve dhe propozimeve të qytetarëve para institucioneve kompetente duke e përdorur platformën e vendosur.</p>	
<p>3.2.</p>	<p>Shërbime publike dhe politika të bazuara në prioritetet qytetare nga fusha e mbrojtjes shëndetësore parandaluese</p>	<p>Është formuar trup koordinues, i përbërë nga shtatë anëtarë, të cilët do të punojnë në koordinimin e aktiviteteve, i cili do të përbëhet nga: një përfaqësues nga çdo organizatë qytetare e përfshirë në këtë aktivitet (5 përfaqësues të organizatave qytetare, nga të cilët një nga niveli nacional dhe katër nga niveli lokal) dhe katër përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, njëri prej të cilëve është përgjegjës për mbrojtjen shëndetësore parandaluese, një përfaqësues nga sektori i planifikimit strategjik. Një përfaqësues i kabinetit të ministrit dhe një përgjegjës për financat.</p>	
		<p>Zhvillimi dhe publikimi i platformës elektronike për informim, monitorim dhe përfshirjen e qytetarëve në programet për mbrojtje shëndetësore parandaluese dhe parashikimin e detyrueshëm të një mekanizmi për mbledhjen, shqyrtimin dhe dhënien e përgjigjes për secilin prej propozimeve të mbledhura nga qytetarët.</p>	
		<p>Është zbatuar fushatë për informim të publikut mbi mundësitë që i ofron platforma, nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të një strategjie komunikimi.</p>	



Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
		Është vendosur bashkëpunim pilot me OQ-të nga Tetova, Kumanova, Shuto Orizari dhe Prilepi për identifikimin e grave dhe fëmijëve nga kategoritë vulnerabile për njohjen me të drejtat e tyre që dalin nga programet për mbrojtje parandaluese.	
3.3.	Shërbime publike dhe politika të bazuara në prioritetet qytetare nga fusha e arsimit	Janë përparuar kapacitetet dhe mundësitë e nxënësve, arsimtarëve, shkollave dhe MASH-it që të ndërtojnë bashkarish arsim të mesëm llogaridhënës, të qashëm, efektiv dhe efikas.	
		Janë përcaktuar fushat me prioritet për nxënësit, prindërit dhe arsimtarët.	
		Vendosja e mjeteve për monitorim	
		Janë ndërmarrë aktivitete për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.	
		Është përmirësuar transparencja nëpërmjet shpalljes së të dhënave dhe informacioneve në ueb-faqet e institucioneve (institucione nacionale, komuna dhe shkolla)	
		Është vendosur mekanizëm për shpallje ligjore të resurseve cilësore të hapura në platformat zyrtare arsimore	
3.4.	Shërbime publike dhe politika të bazuara në prioritetet qytetare nga fusha e sigurimit të shërbimeve publike lokale	Është vendosur mekanizëm i njëtrajtshëm i zbatueshëm për të gjitha komunat për konsultime dhe komunikim me qytetarët për dhënie të inputit të qytetarëve gjatë krijimit të shërbimeve lokale dhe alokimit të mjeteve për zbatimin e tyre në buxhetet lokale, me fokus në qytetarët e mjedisve rurale dhe të marginalizuara.	

Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
3.5	E-shërbime të qasshme në mjediset rurale	<p>Është zbatuar fushatë për promovimin e shërbimeve që qytetarët mund t'i marrin në mënyrë elektronike, në vend nga sporteli.</p> <p>(Aktiviteti do të përfshihet në aktivitetet e rregullta këshillimore të ANZHR-së, kurse informacioni do t'u shpërndahet fermerëve nëpërmjet njësisë rajonale të MBPU dhe nëpërmjet AMFBZHR-së).</p>	Për këtë angazhim nuk janë marrë informacione relevante që të vlerësohet se deri ku është realizimi i arritjeve të parapara.
		Është vendosur rrejtja lokale i ndërmjetësve celularë për të promovuar dhe ndërmjetësuar qasjen në portalin uslugi.gov.mk	
		Është zhvilluar kurikulum për edukim të qytetarëve mbi shkathtësitë themelore digjitale për mjediset rurale dhe të marginalizuara (shkrim-leximi kompjuterik themelor - zoom, internet etj.) dhe zbatimi i trajnimeve.	
		Është zhvilluar kurikulum për edukim të qytetarëve mbi shkathtësitë themelore digjitale për mjediset rurale dhe të marginalizuara (shkrim-leximi kompjuterik themelor - zoom, internet etj.) dhe zbatimi i trajnimeve.	
3.6	Zmadhimi i qasjes te format e garantuara të mbrojtjes së viktimave të tregtisë me njerëz	Janë vendosur ekipe mobile për punë në terren në rajonin e Ohrit dhe të Strugës dhe në rajonin e Shtipit dhe të qyteteve përreth.	
		Mbledhje sistematike e të dhënave mbi tregtinë me njerëz nëpërmjet përdorimit të mjetit në dispozicion për monitorim dhe evalvim të gjendjeve të tregtisë me njerëz në RMV dhe shpallje e tyre e rregullt.	

Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
		<p>Vendosja e bazës së të dhënave për procedurat e ngritura dhe rastet e identifikuar të shfrytëzimit onlajn të fëmijëve dhe publikimi i rregullt i tyre. Raportet me të dhëna sensitive (raportet e brendshme) do të përdoren për menaxhimin e rasteve.</p> <p>Të dhënat do të publikohen edhe në raportet publike që do të jenë në formë të përgjithshme në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, mbrojtjen e identitetit dhe privatësisë, në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e individëve gjatë përpunimit automatik të të dhënave (ETS) nr. 108)</p>	
		<p>Realizimi i së drejtës për kompensim për fëmijët viktimë të tregtisë me njerëz nëpërmjet miratimit dhe publikimit të:</p> <ul style="list-style-type: none"> → programit për kompensimin e fëmijës viktimë në përputhje me Ligjin për drejtësi për fëmijët dhe → informacionit mbi zbatimin e Programit të Kompensimit të Fëmijës Viktimë 	
		<p>Janë zbatuar aktivitete për sensibilizimin dhe informimin e publikut dhe viktimave për realizimin e të drejtave të parashikuara në Ligjin për pagesën e dëmshpërblimit monetar për viktimat nga veprat penale.</p>	
		<p>Janë zbatuar trajnime të rregullta të personelit mjekësor për identifikim, paraqitje dhe drejtim të viktimave të tregtisë me njerëz.</p>	
		<p>Janë zbatuar fushata informuese për njohjen e opinionit me punën dhe shërbimet që i ofrojnë qendrat REP.</p>	
		<p>Janë vendosur programe për rikualifikim dhe ndërtim të shkathtësive për të rriturit dhe fëmijët potencialë dhe/ose viktimë të TNJ-së me qëllim të përgatitjes së tyre më të madhe për punësim, përforsim dhe riintegrim.</p>	

Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
3.7.	Përparimi i mekanizmave për mbrojtje të viktimave për shqetësim në vendin e punës	Informimi i të punësuarve në sektorin publik dhe privat për të drejtët e tyre për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës, që dalin nga Ligji për marrëdhënie pune.	
		Edukimi i personave të përzgjedhur të pavarur në sektorin publik dhe privat si ndërmjetësues në procedurat për zgjidhjen e rasteve të identifikuara të mobingut.	
		Zbatimi i procesit konsultues me të gjitha palët e interesuare për finalizim të Propozim-ligjit për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës.	
3.8.	Mundësimi i qasjes te terapia dhe shërbimet shëndetësore për personat që përdorin droga pas vuajtjes së dënimit me burg.	Zmadhimi i vëllimit të informacionit midis personelit mjekësor në drejtim të ofrimit të trajtimit dhe shërbimeve të duhura për personat që përdorin drogë, nëpërmjet trajnimit.	
		Vendosja e procedurës dhe praktikës së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të përfshira në këtë aktivitet dhe organizatave të shoqërisë qytetare në identifikimin e problemeve me të cilat përballohen personat që përdorin drogë dhe krijimi i zgjidhjeve të përshtatshme për tejkalimin e tyre (detyra e parë është krijimi i një programi për procedurë të thjeshtë dhe të shkurtuar për nxjerrjen e dokumentit për identifikimin personal të personave që përdorin drogë dhe që nuk posedojnë dokument të vlefshëm ose nuk posedojnë asnjë dokument identifikimi gjatë vuajtjes së dënimit me burg)	
		Zmadhimi i vëllimit të informacioneve në dispozicion për të drejtat që rrjedhin nga programi i sigurimeve për personat e pasiguruar, përfshirja e personave të pasiguruar që përdorin drogë dhe që vuajnë dënimin në burg dhe informimi i publikut për mënyrën se si zbatohet programi dhe për ndikimin e tij.	

Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
		<p>Vendosja e një sistemi të hapur, transparent dhe publik për bashkëpunim ndërsektorial ndërmjet qendrave ditore për parandalimin dhe trajtimin e abuzimit me drogën dhe varësinë nga droga, Drejtorisë për zbatimin e sanksioneve, Fondit të sigurimeve shëndetësore, Ministrisë e Punëve të Brendshme dhe organizatave qytetare.</p>	



Procesi është mbështetur nga Sekretariati i PQH- së për nevojat e projektit “Mbështetje e procesit të zbatimit dhe ndjekjes së Planit nacional aksional për Partneritet për qeverisje të hapur 2021 - 2023”, të cilin e zbaton Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedonia në partneritet me Qendrën për komunikime qytetare dhe Shoqatën për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave, në bashkëpunim me Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratë.